

**VENDIM Nr. 353, datë 26.5.2022**  
**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 612, DATË 5.9.2012,**  
**TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,**  
**“PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT ‘PËR AKCIZAT’”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 108 e 109, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Pas pikës 5, të nenit 24 “Humbjet e pakthyeshme”, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Në zbatim të nenit 11 të ligjit, pullat fiskale, që shkatërrohen plotësisht gjatë procesit të vendosjes nga makineritë e prodhimit ose ambalazhimit të produkteve të akcizës, konsiderohen si humbje të pranuar, në rast se konfirmohen me deklaratë vjetore të lëshuar nga fabrikat prodhuese ose ambalazhuese, por, në çdo rast, jo më shumë se niveli mesatar vjetor që nuk kalon 0,5% për artikujt e kapitullit 24 të Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave dhe deri në 1% për rastet e tjera, të totalit të pullave të përdorura nga operatori gjatë vitit. Për këtë sasi pullash, që shkatërrohen plotësisht nga makineritë, nuk përlllogariten detyrime akcize apo penalitete.

6.1 Pullat e akcizës të shkatërruara plotësisht nga makineritë llogariten si vijon: gjendja e pullave në fillim të vitit plus furnizimet gjatë vitit minus totalin e pullave të vendosura në produktet e akcizës gjatë vitit, pullave të kthyera gjatë vitit për t’u asgjësuar me prezencën e organeve doganore dhe gjendjen në fund të vitit.

6.2 Deklarata faktike për humbjet e pranuar të pullave, që shkatërrohen plotësisht nga makineritë dhe nuk mund t’i kthehen fizikisht organeve doganore, hartohet nga prodhuesit e mallrave që bëjnë vendosjen e pullave dhe depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave brenda datës 31 mars të çdo viti, për vitin e mëparshëm kalendarik. Operatorët, që furnizohen nga disa fabrika prodhuese jashtë vendit, bëjnë një deklaratë përmbledhëse vjetore, e cila paraqitet nga operatori në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave brenda datës 31 mars të çdo viti, për vitin e mëparshëm kalendarik.”.

**Neni 2**

Në nenin 48/1, “Produktet e akcizës pa pullë fiskale, që pranohen në një magazinë fiskale stokimi/magazinë doganore”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Vendosja e pullave të akcizës në ambientet e magazinave fiskale të stokimit/magazinave doganore kryhet sipas përcaktimeve të nenit 41, të ligjit.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Në përfundim të procesit të vendosjes së pullave të akcizës në produktet e akcizës hartohet procesverbali përkatës, në të cilin pasqyrohen të gjitha të dhënat në lidhje me sasinë e pullave të akcizës të vendosura dhe sasinë e produkteve të akcizës sipas llojeve tek të cilat u aplikuan pullat e akcizës. Në rastet kur autoritetet doganore mbikëqyrëse sigurojnë prezencën gjatë procesit të vendosjes së pullave, procesverbali nënshkruhet nga përfaqësuesi i autoriteteve doganore dhe depozituesi i miratuar/importuesi.”.

### **Neni 3**

#### **Dispozitë tranzitore**

Për periudhat e mëparshme përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, operatorët kanë afat deri më 31 korrik 2022, për dorëzimin e deklaratave faktike për humbjet e pranuar, sipas parashikimeve të nenit 1, të këtij vendimi.

### **Neni 4**

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

Botuar ne F.Zyrtare 81/2022

Dale nga shtypi me 31.05.2022